

VENDIM
Nr.288 datë 1.7.1992

PËR SISTEMIN E TREGUT VALUTOR

Në bazë të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 "Për sistemin bankar", dhe të ligjit nr.7559, datë 22.4.1992 "Për Bankën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kursi i këmbimit të lejuar ndaj valutave të huaja të përcaktohet mbi bazën e transaksioneve të tregut, të kryera lirisht ndërmjet palëve në bazë të kërkesës dhe ofertës.

2. Banka e Shqipërisë autorizon bankat dhe agjentët e tjerë të këmbimeve valutore të kryejnë veprime në këtë treg. Banka e Shqipërisë do të përcaktojë kufijtë e veprimeve në këtë treg, për të parandaluar që ndonjë pjesëmarrës të mbizotërojë tregun.

3. Bankat dhe agjentët e tjerë të autorizuar për të kryer këmbime valutore janë ligjërisht përgjegjës që veprimet e tyre të këmbimeve valutore të jenë në përputhje me këto dispozita.

4. Bankat dhe agjentët e tjerë të autorizuar për të kryer transaksione në tregun valutor i raportojnë çdo ditë Bankës së Shqipërisë vëllimin dhe kursin mesatar të zbatuar gjatë ditës për çdo monedhë të tregtuar.

5. Banka e Shqipërisë llogarit dhe shpall çdo ditë kursin mesatar të këmbimit që mbizotëron në treg. Me këtë kurs këmbimi kryhen dhe veprimet ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë. Të gjitha veprimet e tjera të Bankës së Shqipërisë në tregun e këmbimeve valutore bëhen me kursin që mbizotëron në treg, i cili diskutohet ndërmjet palëve sipas kërkesës dhe ofertës.

6. Të gjitha firmat private e shtetërore dhe individët që veprojnë në sektorin e eksportit, duhet të riatdheshojnë në Shqipëri të gjitha arkëtimet në valutë të huaj nëpërmjet sistemit bankar vendas, brenda 30 ditëve pas arkëtimit të tyre, por ata janë të lirë t'i mbajnë këto arkëtime brenda ose jashtë sistemit bankar, apo t'i konvertojnë ato në lekë me kursin e këmbimit që mbizotëron në treg. Për mallrat që mund të eksportohen lirisht, kërkesat për dokumentimin e këtyre arkëtimeve zëvendësojnë licencën e eksportit.

7. Firmat private a shtetërore dhe individët, rezidentë ose jorezidentë, janë të lirë të mbajnë llogari në valutë në bankat brenda vendit dhe të kryejnë veprime në valutë me çdo rezident, por i nënshtrohen kërkesës së lartpërmendur për riatdheshim. Vetëm bankat autorizohen të hapin llogari jashtë shtetit.

8. Bankat e autorizuar do të mbajnë 100 për qind mbulesë (rezervë) të depozitave në valutë të vendosur pranë tyre. Banka e Shqipërisë do ta mbikqyrë këtë kërkesë dhe do të përcaktojë udhëzimet për bankat e tjera.

9. Të gjitha të ardhurat në valutë të Qeverisë do të mbahen në llogari në valutë në Bankën e Shqipërisë, ose do t'i shtoten asaj në kursin mesatar të tregut të llogaritur nga Banka e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mund t'i shesë sistemit bankar tepricat valutore mbi detyrimet e pritshme valutore, pasi të ketë krijuar rezervën zyrtare në valutë të huaj. Për këto shitje zbatohet kursi i këmbimit që mbizotëron në treg, në kohën e kryerjes së transaksioneve.

10. Në kushtet kur në Bankën e Shqipërisë gjendja e valutës nuk përmbush detyrimet e papaguara dhe kuotat e rezervës, Banka e Shqipërisë do të blejë shumën e nevojshme nga bankat ose tregtarët e valutës, me kursin e këmbimit që mbizotëron në treg në kohën e blerjes. Për këto raste nuk njihen subvencione dhe humbje.

11. Për pagesat dhe transferimet për transaksionet korrente me jashtë nuk ka kufizime. Për të rritur efektivitetin dhe kontrollin mbi transferimin jashtë shtetit të kapitaleve, do të vendosen disa kufij për importin dhe pagesat jotregtare. Për udhëtimet turistike jashtë shtetit lejohet marrja e 150 dollarë USA në ditë për 1 person, kurse për udhëtime private punë (biznes jashtë shtetit) lejohet marrja për person e 200 dollarëve USA në ditë. Për shumat mbi këto limite do të kërkojnë dokumente, për t'u siguruar që nuk bëhet fjalë për transferim kapitali.

Për personat që udhëtojnë jashtë shtetit për punë, nuk shërbejnë kufizimet e mësipërme. Këto do të jenë subjekt i disiplinës buxhetore, e përcaktuar me dispozita të veçanta të Këshillit të

Ministrave.

Për listat e mallrave, të lejuara për t'u importua [a licencë, bankat do të shesin valutë për kryerjen e pagesave të importit pa kufizim.

Shumat bazë, të lejueshme për pagesat e importit, përcasktohen nga dokumentacioni përkatës doganor. Për imoportet që janë lejuar nga dogana e që nuk bëjnë pjesë në listat e importeve të ndaluar, nuk pengohet dhënia e valutës.

Verifikimet nëse pagesat për importet dhe shërbimet janë sipas rregullave të transferimit të kapitalit jashtë shtetit, bëhen duke u mbështetur në dokumentacionin e përpiluar pas blerjes së valutës.

12. Transferimi i kapitalit jashtë shtetit bëhet me miratimin e Bankës së Shqipërisë. Për individët dhe firmat jorezidente normalisht nuk lejohet dhënia e huasë në Shqipëri. Përderisa të rikrijohen rezervat valutore, shuma e lejueshme për t'u dërguar të afërve emigrantëve jashtë shtetit për çdo të rritur është 1000 dollarë USA në vit dhe për çdo fëmijë 500 dollarë USA në vit.

13. Transferimet e kapitalit brenda vendit mund të kryhen lirisht nga rezidentet ose jorezidentët. Hyrjet e kapitalit që janë regjistruar, mund të transferohen më pas lirshëm jashtë shtetit në rrethana normale. Dërgesat e fitimit dhe dividendët që rrjedhin nga ky kapital i regjistruar, mund të transferohen gjithashtu lirshëm jashtë shtetit.

14. Në rregulloren e Bankës së Shqipërisë për tregun valutor të përshkruhen përgjegjësitë e tregtarëve me licencë për mbajtjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe për të zbatuar rregullat e përcaktuara në këtë rregullore.

15. Ky vendim dhe rregullorja e tregut valutor të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë, zëvendësojnë të gjitha aktet normative dhe rregulloret ekzistuese për transaksionet valutore. Sipas këtyre vendimeve, kërkesat për licencë eksport import janë liberalizuar në një vend të veçantë.

16. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, të gjitha kontratat e veprimet e tregtisë së brendshme e të shërbimeve vlerësohen dhe kryhen vetëm në lekë. Bëjnë përjashtim dyqanet e valutës në pikat kufitare dhe në aeroport.

17. Banka e Shqipërisë do të nxjerrë rregullat shtesë dhe instruksionet teknike për veprimet e bankave e të tregtarëve të pajisur me licencë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi